



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVO  
KOMUNA E GJAKOVËS  
OPŠTINA DJAKOVICA/MUNICIPALITY OF GJAKOVA

## Njësia e Prokurimit

Gjakovë, datë 03.11.2022

Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit i Komunës së Gjakovës, në mbështetje të nenit 108/A (paragrafi 10.1) të Ligjit mbi Prokurimin Publik nr. 04/L-042, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092, duke u bazuar në nenin 8 (paragrafi 8.1.2) të Rregullës për Parashtrimin e Ankesave të publikuar nga Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik, duke vendosur sipas kërkesës për ri-shqyrtim të datës 31.10.2022, të parashtruar nga Operatori Ekonomik " **BERISHA COM** " SH.P.K, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull : "Ndërtimi dhe sanimi i parqeve " , **Nr. i prokurimit- 632-22-4421-5-2-1, Nr. i brendshëm-632-22-020-521**, nxjerr:

### V E N D I M

- 1. Refuzohet** si e pa bazuar Kërkesa për ri-shqyrtim e Operatorit Ekonomik " **BERISHA COM** " SH.P.K., e dt.31.10.2022, lidhur me aktivitetin e prokurimit "Ndërtimi dhe sanimi i parqeve " , **Nr. i prokurimit- 632-22-4421-5-2-1, Nr. i brendshëm-632-22-020-521**, kundër **NJOFTIM MBI VENDIMIN E AUTORITETIT KONTRAKTUES** , te AK –së, të datës 26.10.2022, të publikuar në platformën elektronike të KRPP.
- 2. Vërtetohet NJOFTIMI MBI VENDIMIN E AUTORITETIT KONTRAKTUES** të publikuar me datë 26.10.2022;
3. Autoriteti Kontraktues, vendos që të vazhdoj me procedurat e prokurimit;
4. Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit dhe të publikohet në platformën elektronike të KRPP.

## Ar sy e t i m

Me dt.31.10.2022, Operatori Ekonomik " BERISHA COM " SH.P.K., ka parashtuar Kërkesë për rishqyrtim lidhur me aktivitetin prokurimit: "Ndërtimi dhe sanimi i parqeve " , Nr. i prokurimit- 632-22-4421-5-2-1, Nr. i brendshëm-632-22-020-521.

Autoriteti Kontraktues Komuna e Gjakovës, me datë 03.11.2022, ka shqyrtuar kërkesën për rishqyrtim si më poshtë:

Autoriteti Kontraktues ka refuzuar **Ofertën tuaj për çmimin jo-normalisht të ulët, te cilin vendim e ka mbështet në Vendimin e Organit Shqyrtues te Prokurimit PSH.nr.289/22 te datës 20.09.2022.**

Zyrtari Përgjegjës i prokurimit bazuar ne ato që u thane më lart ka vendosur si ne dispozitiv.

### **Këshilla juridike:**

Kundër këtij vendimi, ankuesi mund të paraqesë ankesë pranë OSHP-së . **Ankesa pranë OSHP-se duhet te dorezohet brenda 10 (dhjete) diteve pas pranimit te ketij vendimi.**

  
**Faton Gutaj**  
Menaxher i Zyrës së Prokurimit

**Kopje:** Operatorit Ekonomik;  
Zyrës së Kryetarit te Komunës;  
Te gjitha palëve te interesuara;  
Arkivit të Komunës